

European Movement Albania

**BROSHURË INFORMATIVE
MBI PROCESIN E
LIBERALIZIMIT TË VIZAVE**

*Të drejtat dhe detyrimet që lindin
nga heqja e regjimit të vizave
për qëndrim afatshkurtër
me hapësirën Shengen*

Nëntor 2010



Ky botim u realizua nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit "Procesi i Liberalizimit të Vizave me Shqipërinë: Si ta kthejmë në një histori sukseesi? mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Mendimet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e organizatës mbështetëse.

Shtypur në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese FLESH
Tiranë, Tel/fax: 04 2248 664

© European Movement in Albania
Tiranë, Nëntor 2010



European Movement Albania
Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.8, Tiranë 1001, Albania
Tel/Fax: +355 4 2253184
www.em-al.org
info@em-al.org

Përmbajtja:

1. Hyrje	5
1. Konteksti Historik.....	7
2. Momentet kryesore në trajektoren e Shqipërisë drejt Liberalizimit të Vizave	11
3. Udhëtimi pa viza në Hapësirën Shengen.....	11
4. Vendet në të cilat mund të udhëtohet pa vizë.....	14
5. Rëndësia e pajisjes me pasaportë biometrike.	15
6. Programet e shkëmbimit për studentë, hulumtues dhe akademikë.....	15
7. Përfitimet e Komunitetit të Biznesit.....	18

HYRJE

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve në sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritit europian. Ajo, në mënyrë analitike vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit europian. Në kuadër të këtij qëllimi vjen edhe publikimi i kësaj broshure informative e cila merr shkas nga heqja e regjimit të vizave me vendet e hapësirës Shengen. “Broshura Informative mbi Procesin e Liberalizimit të Vizave. Të drejtat dhe detyrimet që lindin nga heqja e regjimit të vizave për qëndrim afatshkurtër me hapësirën Shengen” u hartua në kuadër të projektit “Procesi i Liberalizimit të Vizave me Shqipërinë: Si ta kthejmë në një histori suksesi? mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Kjo broshurë është hartuar për të informuar dhe ndërgjyësuar opinionin publik në tërësi mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin nga heqja e regjimit të vizave afatshkurtër me hapësirën Shengen. Ajo ofron një panoramë të përgjithshme të kontekstit historik të procesit që nga fillimet e tij duke evidentuar në mënyrë të qartë momentet kryesore. Në brendësi të saj do të gjeni informacion më të detajuar mbi vendet në të cilat mund të udhëtohet pa vizë, kohëzgjatjen e qëndrimit dhe ndëshkimet në rast mos respektimi të këtyre afateve si dhe dokumentet e nevojshme me të cilat duhet të jetë i pajisur një udhëtar.

Gjithashtu, një hapësirë e veçantë në broshurë i dedikohet grupeve të caktuara të interesit si: studentëve, akademikëve dhe komunitetit të biznesit, të cilat EMA vlerëson se potencialisht do të jenë përfituesit më të mëdhenj nga liberalizimi i vizave. Kjo pjesë e broshurës ofron informacion më të gjerë, mbi programet e BE-së nga të cilat mund të përfitojnë studentët dhe akademikët.

Lexim të këndshëm!

Konteksti historik

Prespektiva e liberalizimit të vizave për Shqipërinë si dhe për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor mori jetë në samitin e Selanikut të Bashkimit Europian në qershor të vitit 2003. Marrëveshja e Ripranimit miratuar në 2005 ishte guri i parë në themelet e këtij procesi i cili u pasua me Marrëveshjen e Lehtësimit të Vizave (MLV). Kjo marrëveshje hyri në fuqi më 1 Janar 2008, duke shënuar hapin e parë konkret në rrugën drejt një regjimi pa viza për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

MLV-ja synonte lehtësimin e lëvizjes për 90 ditë kohë qëndrimi brenda një periudhe 180 ditore për të ashtuquajturit “faktorët e shkëmbimit”¹. Në të njëjtën kohë ajo parashikonte:

- shkurtimin e procedurave të pajisjes me vizë Shengen deri në 10 ditë punë në përjashtim të rasteve kur verifikime të mëtejshme kërkohen;
- heqjen e vizave për poseduesit e pasaportave diplomatike;
- mbajtjen në kuotën e 35 eurove të tarifës së aplikimit për vizë për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe për heqjen e kësaj tarife për kategori të caktuara si dhe mundësin e dhënies së vizave afatgjata dhe me

¹ Në faktorët e shkëmbimit bëjnë pjesë: anëtarë të delegacioneve zyrtare; përfaqësues të komunitetit të biznesit; gazetarë; përfaqësues të shoqërisë civile; nxënës, student, pedagogë; persona që marrin pjesë në aktivitete shkencore, kulturore dhe artistike; pjesëmarrësit në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare; familjarët e afërt, bashkëshortët, fëmijët, prindërit, gjyshërit, nipërit dhe mbesat, vëllezërit dhe motrat duke përfshirë dhe fëmijët e tyre sportistët dhe turistët.

shumë kalime për ato kategori personash që kanë shkëmbime të shpeshta në vendet e Shengenit.

Edhe pse MLV-ja u trumbetua si një hap i suksesshëm i cili do unifikonte dhe thjeshtëzonte procedurat e aplikimit për vizë Shengen, ajo nuk solli ndryshime thelbësore në këtë drejtim. Me përjashtim të heqjes së tarifës së vizës për disa nga “faktorët e shkëmbimit”, procedurat dhe dokumentet e nevojshme për tu paraqitur pranë konsullatave të ndryshme mbetën të pa harmonizuara. Limitet kohore për trajtimin e praktikave të parashikuara nga MLV-ja jo gjithmonë respektoheshin dhe kostoja e dokumenteve të nevojshme për aplikim mbeti e lartë. Pavarësisht se palët nënshkruese të MVL-së janë Shqipëria dhe Komuniteti European, zbatimi i kësaj marrëveshje ishte plotësisht në dëshirën e vendeve anëtare të BE.

Në pranverën e vitit 2008, Komisioni European prezantoi Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave, në të cilin u trupëzuan 42 standarde, përmbushja e të cilëve do të mundësonte heqjen e regjimit të vizave. Këto standarde janë të organizuara në katër blloqe:

- Siguria e dokumenteve;
- Migracioni i paligjshëm dhe ripranimi;
- Rendi dhe siguria publike;
- Marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore.

Dorëzimi i Udhërrëfyesit ishte një tjetër moment shumë i rëndësishëm në këtë proces pasi jo vetëm që e vendosi Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor përballë të njëjtin kriter vlerësimi por pohoi faktin se progresi drejt liberalizimit të vizave do të kalonte përmes meritave individuale të secilit vend drejt përmbushjeve të këtyre standardeve.

Trajektorja që Komisioni European ndoqi deri në vlerësimin përfundimtar për heqjen e regjimit të vizave mbështetej në mekanizmin e raportim- monitorimit midis qeverisë shqiptare dhe Komisionit European. Në thelb të këtij mekanizmi ishte ideja që qeveria Shqiptare, ashtu sikurse qeveritë e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, i dorëzonte me shkrim Komisionit European raporte periodike mbi stadin e progresit të arritur në drejtim të përmbushjes së standardeve. Nga ana tjetër, Komisioni përpilonte raporte vlerësimi bazuar mbi raportet e qeverisë si dhe nga vetë vlerësimi i situatës në terren. Këto raporte diskutoheshin në Këshillin e BE për Ballkanin Perëndimor (COWEB). Gjatë këtij procesi Komisioni European ka hartuar 5 Raporte Vlerësimi² për Shqipërinë.

Bazuar në këto vlerësime Komisioni European propozoi heqjen e regjimit të vizave për Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi, vendim i cili hyri në fuqi në 19 dhjetor 2009. Ndërkohë që Shqipëria dhe Bosnje Hercegovina vazhduan të mbeten në listën negative të Shengenit për shkak të mungesës së progresit të mjaftueshëm në përmbushjen e kritereve të Udhërrëfyesit.

Në fund të prillit 2009, grupi i ekspertëve të monitorimit përgatiti raportin e katërt të vlerësimit në bazë të së cilit Komisioni European propozoi heqjen e regjimit të vizave për Shqipërinë dhe Bosnje Hercegovinën. Në propozimin e tij për Shqipërinë, Komisioni u shpreh se pavarësisht progresit të arritur deri më tani, reforma të mëtejshme nevojiten për të adresuar tre standartet ende të hapura që kishin të bënin me³ :

² Raportet e Vlerësimit të Komisionit European mbajnë datat : 24 Nëntor 2008, 18 Maj 2009, Janar- shkurt 2010, 19 Prill 2010 dhe 14 Shtator 2010.


³ Raporti i Vlerësimit të Komisionit European, 25 prill 2010.

- Zhvillimin e strategjisë dhe politikave për të mbështetur riintegrimin e personave të rikthyer;
- Forcimin e kapaciteteve të zbatimit të ligjit dhe zbatimin efektiv të kuadrit ligjor për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë këtu nevojën për burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore.
- Zbatimin efektiv të kuadrit ligjor në fushën e konfiskimit të aseteve të krimit të organizuar.

Misioni i fundit i ekspertëve që vizitoi Shqipërinë në korrik të 2010, përgatiti një opinion sipas të cilit Shqipëria kishte përmbushur kriteret e mbetura. Ky vlerësim u shoqërua me propozimin legjislativ të Komisionit Europian për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët shqiptarë dhe boshnjakë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës propozimi legjislativ i Komisionit Europian iu nënshtrua procedura të bashkëvendimmarrjes midis Parlamentit Europian dhe Këshillit të Ministrave të Punëve të Brendshme dhe Drejtësisë. Duke filluar nga 15 dhjetori 2010, qytetarët shqiptarë dhe ata boshnjakë udhëtojnë pa viza në hapësirën Shengen.

MOMENTET KRYESORE NË TRAJKTOREN E SHQIPËRISË DREJT LIBERALIZIMIT TË VIZAVE




Udhëtimi pa viza në Hapësirën Shengen


Qytetarët shqiptarë nuk do të kenë më nevojë të pajisën me viza afat shkurtër të tipit “C” për të udhëtuar në hapësirën Shengen. Për të përfituar nga ky regjim duhet që qytetarët të zotërojnë një pasaportë biometrike. Udhëtimi pa viza mund të bëhet për arsye turistike, familjare, biznesi apo studimi afatshkurtër deri në një afat 90 ditor brenda një harku kohor prej 180 ditësh, që nga momenti i parë i kalimit të kufirit të zonës Shengen. Qëndrimi përtej këtij afati pa u pajisur me leje qëndrimi apo punësimi konsiderohet e paligjshme dhe si e tillë rregullorja Shengenit ka parashikuar sanksione që bazohen në legjislacion kombëtar të vendeve anëtare të Shengenit.

Liberalizimi i vizave afat shkurtër nuk nënkupton heqjen e regjimit të vizave për qëllime punësimi apo studimi që tejkalon periudhën 90 ditore. Personat që për shkak të profesionit të tyre i duhet të udhëtojnë shpesh sic mund të jenë shoferët duhet të jenë shumë të kujdesshëm për të llogaritur periudhën 90 ditore brenda një afati 180 ditore ose të aplikojnë për viza afatgjatë të tipit “D”.

Një shembull i shpërndarjeve të ditëve të udhëtimit paraqitet si më poshtë:



Periudha maksimale e vazhdueshme e qëndrimit gjatë një viti



Periudha maksimale me qëndrime të shkurtra gjatë një viti

Në rastet kur planifikohet të udhëtohet për punësim, jetesë apo shkollim që e tejkalojnë periudhën e përcaktuar, është e domosdoshme pajisja me vizë afatgjate të tipit “D”, e cila do të konvertohet në leje qëndrimi.

Pas heqjes së regjimit të vizave të tipit “C” për qëndrim afat shkurtër, përgjegjësia për lëvizjen e qytetarëve kalon nga konsullatat tek autoritetet e pikave kufitare të Shqipërisë dhe vendeve anëtare të Shengenit. Kjo i jep të drejtë këtyre autoriteteve që krahas kontrollit të dokumentit të udhëtimit (pasaportës biometrike) t’i kërkojnë qytetarëve:

- informacione mbi udhëtimin e tyre duke i dëshmuar rezervimin e hotelit ose adresën e qëndrimit,
- të specifikojnë arsyet e udhëtimit,
- mjetet financiare me të cilat do të sigurojnë jo vetëm jetesën gjatë qëndrimit në hapësirën Shengen por edhe mjetet e nevojshme financiare për kthimin e tyre në Shqipëri,
- siguracionin shëndetësor ose automobilistik.

Duke iu referuar Marrëveshjes së Ripranimit midis Shqipërisë dhe Komunitetit Europian si dhe Ligjit për Kufirin, policia kufitare dhe migracionit duhet të zbatojë detyrimet, që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, marrëveshjet dy apo shumëpalëshe për shkëmbimin e të dhënave me organet homologe të vendeve të tjera. Sipas nenit 6 pika 5 në Ligjin për Kufirit përcaktohet shprehimisht që udhëtarët do ti nënshtrohen fillimisht kontrollit dhe intervistimit në pikat e kalimit kufitar nga policia shqiptare kufitare dhe migracionit. Në rastet kur policia kufitare dhe migracionit gjykon se udhëtari nuk arsyeton mjaftueshëm qëllimin e udhëtimit, ajo ka të drejtë të ndalojë që në territorin shqiptar kalimin e tij në hapësirën Shengen.

Autoritetet kufitare kanë të drejtë të refuzojnë hyrjen në hapësirën Shengen në rastet kur udhëtari:

- Refuzon të respektojë kërkesat e parashtruara më lart nga autoritetet kufitare;
- Nuk arsyeton mjaftueshëm qëllimin e udhëtimit;
- Konsiderohet se përbën kërcënim për rendin, sigurinë dhe shëndetin publik të shtetit në të cilën ai hyn;
- Ka precedentë të mëparshëm që i pengojnë hyrjen në hapësirën Shengen.

Kësisoj bazuar në Konventën e Shengenit, janë pikërisht autoritetet kufitare të cilët japin vendim përfundimtar lidhur me hyrjen ose jo në hapësirën Shengen ⁴.

⁴ Kjo e drejtë bazohet në Nenin 5 të Konventës Shengen ku sanksionohet: “Cdo personi që nuk plotëson kushtet e mësipërme mund ti refuzohet hyrja në hapësirën Shengen përveç rasteve kur një vend anëtarë i Shengenit e konsideron të nevojshme të heqë dorë nga ky parim për arsye humanitare, në bazë të interesit kombëtar ose për shkak të detyrimeve ndërkombëtare. Në raste të tilla përgjegjësia do të jetë e kufizuar në territorin e vendit në fjalë, i cili duhet të informojë vendet e tjera të Shengenit në përputhje me rrethanat.

Vendet në të cilat mund të udhëtohet pa vizë

Pas heqjes së regjimit të vizave qytetarët shqiptarë kanë të drejtë të lëvizin pa viza në të gjithë hapësirën Shengen, e përbërë nga: Austria, Belgjika, Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Islanda, Norvegjia, dhe Zvicra. Megjithatë, edhe brenda kësaj hapësire ka përjashtime për territore të caktuara të tilla si: ishujt Faroe dhe Grenlanda (Danimarkë), Ceuta dhe Melita (Spanjë), Svalbard (Norvegji), Aruba, Curaçao, Sint Maarten dhe ishujt BES (Holandë).

Nga 28 vendet e Shengenit 25 prej tyre duke përjashtuar Islandën, Norvegjinë dhe Zvicrën janë anëtarë të BE. Ndërkohë që nuk mund të udhëtohet pa vizë në vendet anëtarë të BE si Britania e Bashkuar dhe Irlanda, të cilat nuk janë në hapësirën Shengen.

<p>Shtetet në të cilat mund të udhëtohet pa vizë</p>	<p>Vende Anëtare të BE-së dhe Shengenit: Austri, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Holandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi.</p> <p>Megjithatë, edhe brenda kësaj hapësire ka përjashtime për territore të caktuara të tilla si: ishujt Faroe dhe Grenlanda (Danimarkë), Ceuta dhe Melita (Spanjë), Svalbard (Norvegji), Aruba, Curaçao, Sint Maarten dhe ishujt BES (Holandë).</p> <p>Vende jo anëtare të BE-së: Islandë, Norvegji Zvicër.</p>
<p>Vendet Anëtare të BE-së ku NUK mund të udhëtohet pa vizë</p>	<p>Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda.</p>

Rëndësia e pajisjes me pasaporta biometrike

Vetëm qytetarët e pajisur me pasaportë biometrike përfitojnë nga heqja e regjimit të vizave me hapësirën Shengen. Për t'u pajisur me pasaportën biometrike është e domosdoshme që cdo qytetar të jetë zotërues i një letërnjoftimi elektronik. Çdo individ mbi moshën 16 vjeç ka të drejtën të pajiset me pasaportën biometrike. Aplikimet për letërnjoftim elektronike ashtu sikurse edhe për pasaportë biometrike bëhen pranë zyrave të aplikimit që ndodhen në Zyrat e Gjendjes Civile, të njësisë së qeverisjes vendore, pranë vendbanimit.

Programet e shkëmbimit për studentë, hulumtues dhe akademikë

Procesi i liberalizimit të vizave ndihmon komunitetin e studentëve, hulumtuesve dhe pedagogëve, të cilët përmes programeve të shkëmbimit do të mund të rrisin kapacitetet e tyre profesionale. Heqja e regjimit të vizave do t'i lehtësojë të rinjtë shqiptarë të profesioneve dhe disiplinave të ndryshme që krahas pjesëmarrjes në konferenca, seminare, trajnime ndërkombëtare, të kenë mundësi që të përfitojnë edhe nga programet e ndryshme të Bashkimit Europian. Jo vetëm kaq, por edukimi me kulturën perëndimore si dhe njohja me metoda të reja mësimdhënie, do të shërbejnë si katalizatorë për një përqasje reformuese ndaj sistemit të edukimit dhe arsimimit në Shqipëri.

Disa nga programet deri më 3 muaj të Bashkimit Europian pjesë e politikave të Lifelong Learning ku Shqipëria mund të marrë pjesë paraqiten si më poshtë⁵:

⁵ Më shumë informacion mbi programet e lartë përmendura dhe të tjera si këto që Bashkimi Europian ofron, mund të gjeni në adresën e internetit : http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc28_en.htm.

Lloji i programit	Kategoria e përfituesve	Kohëzgjatja
<p>Erasmus Mundus – ofron mbështetje për studentë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për të kryer studimet pasuniversitare në unive-rsitet e vendeve të BE.</p>	<p>Kategoria 1: - akademikët - kërkues politikash/hulumtues Kësaj kategorie i ofrohet mundësia e ndjekjes së kurseve të ndryshme profesionale.</p> <p>Kategoria 2: - Studentë që dëshirojnë të kryejnë studimet pasuniversitare - Pedagoge, hulumtues të cilët dëshirojnë të kryejnë studimet e doktoraturës dhe post doktoraturës</p>	<p>Periudhë afatshkurtër që varion nga 1 – 3 muaj</p> <p>Periudhë afatgjatë që varion nga 1 – 3 vjet</p>
<p>TEMPUS synon modernizimin e arsimit të lartë në shtetet e Europës Lindore, Ballkanit Perëndimor, dhe Azisë Qendrore.</p> <p>TEMPUS-i është i hapur vetëm për individë që aplikojnë përmes institucioneve të arsimit të lartë ose organizmave të tjera që veprojnë në fushë e arsimit, shkencës dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Kategoria 1: - Institucionet e arsimit të lartë - Çdo organizate që punon në fushën e arsimit dhe shkencës (institute kërkimi, OJF, grupe profesorësh, etj) që duan të marrin pjesë në implementim e projekteve të përbashkëta.</p> <p>Kategoria 2: - Studentë - Akademike - Stafi i universiteteve - Nëpunës të administratës publike të cilët nuk marrin pjesë si individë por në kuadër të implementimit të projekteve të ndryshme.</p>	<p>Periudhë afatshkurtër që lidhet kryesisht me pjesëmarrje në aktivitete apo konferenca që organizohen në kuadër të projekteve.</p> <p>Kjo kohëzgjatje varion nga 1 – 3 muaj</p>

<p>FP 7 / Programi Kuadër 7 i BE për periudhën 2007 – 2013. Ky program ofron një mundësi për t’iu përgjigjur nevojave të kohës me të cilat po ndeshet BE lidhur me punësimin, konkurrencëshmërinë, dhe lidhësinë në një ekonomi globale të njohurive. FP7 është i strukturuar në 4 shtylla kryesore (bashkëpunim, Idetë, individët dhe kapacitetet).</p> <p>Pjesë e këtij programi janë paketa të veçanta të cilat është Marie Curie Action.</p> <p>Mund të konsiderohen paketa për shkak se në përbërje të saj gjenden një shumëllojshmëri fellowshipesh për kategori të ndryshme.</p>	<p>Përfituesit nga FP7 janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - institutet ose qendrat e kërkimit shkencor pranë universiteteve - kompanitë që tentojnë drejt inovacionit - ndërmarrjet e mesme (SMEs) dhe të vogla - administrata publike (nivel qendror dhe vendor) - të sapo diplomuarit - kërkues politikash - shoqëria civile <p>Përfituesit nga Marie Curie Action</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të sapo diplomuarit të cilët dëshirojnë të profilizohen në një drejtim të caktuar dhe të marrin eksperiencat e vendeve të zhvilluara perëndimore. - Ekspertë të cilët dëshirojnë të rrisin ekspertizën e tyre përmes angazhimit në hulumtim apo inovacion në një nga institucionet e kërkimit shkencor në BE. 	<p>Kohëzgjatja e Marie Curie Action varion nga 3 – 36 muaj në varësi të fellowshipeve specifike që përmban kjo paketë.</p>
---	---	--

Përfitimet e Komunitetit të Biznesit

Pas një periudhe të vështirë operimi si pasojë e izolimit të gjatë për shkak të barrierave që paraqiste procesi i marrjes së një vize Shengen, liberalizimi i vizave pritet ti japë frymëmarrje të re biznesit shqiptar. Radhët e gjata për marrjen e një vize, lista e gjatë dhe e kushtueshme e dokumenteve të detyrueshme për t'u paraqitur në konsullatat apo ambasadat e vendeve të Shengenit, dhe mbi të gjitha periudha e tej zgjatur në disa raste e procesit të verifikimit tashmë do të konsiderohen si një kapitull i mbyllur për biznesin vendas. Regjimi pa viza do ti mundësojë biznesmenëve qarkullim më të mirë dhe më të shpejtë, duke krijuar kështu një mjedis më favorizues dhe mbështetës për zhvillimin e biznesit në Shqipëri. Potencialisht liberalizimi i vizave afatshkurtër i lehtëson biznesit shqiptarë hyrjen dhe aksesimin e tregut evropian, duke mundësuar lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit dhe punonjësve bazuar kjo në nenin 16⁶ dhe 55⁷ të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Liberalizimi i vizave do ti japë një tjetër hov shkëmbimeve tregtare midis Shqipërisë dhe vendeve të Shengenit e si pasojë kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në treguesit e zhvillimit ekonomik të vendit. Njëkohësisht krahas rritjes së shkëmbimeve, përmirësime do të vihen re edhe në treguesit e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në konferenca, simpoziume, seminare, panairë dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare tregtare që do të organizohen.

⁶ Mbi lëvizjen e lirë të mallrave.

⁷ Mbi të drejtën e vendosjes së kompanive dhe lëvizjes së personelit kyç.

Pjesëmarrja në këto aktivitete do t'i ofrojë komunitetit shqiptar të biznesit mundësi bashkëpunimi me kompani të huaja të cilat do të shkëmbejnë midis tyre eksperiencat dhe njohuritë në fushën e teknologjisë dhe marketingut.

Këto bashkëpunime dhe partneritete midis kompanive shqiptare dhe atyre ndërkombëtare do të shërbejnë si një marketing i mirë për biznesin vendas përtej kufijve duke kontribuar kështu në rritjen e kredibilitetit të tyre në sytë e klientëve të huaj. Gjithashtu, nuk duhet harruar se këto bashkëpunime do ta mbajnë biznesin shqiptar në koherencë me zhvillimet më të fundit të teknologjisë në botë.

Mundësimi i të gjitha këtyre elementëve në sajë të procesit të liberalizimit të vizave do të amplifikojnë treguesit e zhvillimit ekonomik jo vetëm në terma afatshkurtër. Azhurnimi me eksperiencat e suksesshme evropiane dhe zbulimet më të fundit të teknologjisë si dhe rritja e bashkëpunimit me kompani ndërkombëtare janë kredenciale/asete të cilat do të shfrytëzohen në të ardhmen për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare në terma afatgjatë.

